

VENDIM
Nr. 1048, datë 23.12.2015

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTEVE NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS
(DATË 30 QERSHOR 2008, MARRËVESHJE HUAJE NR. ABA-P3), NDËRMJET QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM
NDËRKOMBËTAR (TË ZËVENDËSUAR NGA AGJENCIA JAPONEZE E
BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR NË TETOR 2008), PËR PROJEKTIN
“PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE PËR TIRANËN
E MADHE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit ndryshues (letra e JICA, datë 23 tetor 2015), të marrëveshjes së huasë (datë 30 qershor 2008, marrëveshje huaje nr. ABA-P3), ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndër-kombëtar (të zëvendësuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në tetor 2008), për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e dokumentit ndryshues: Rishpërndarje e fondeve të huas (letra e JICA, datë 28 tetor 2015), të marrëveshjes së huas (datë 30 qershor 2008, marrëveshje huaje nr. ABA-P3), ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (të zëvendësuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në tetor 2008), për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Miratimin e dokumentit ndryshues (letra e JICA, datë 4 nëntor 2015), të marrëveshjes së huasë (datë 30 qershor 2008, marrëveshje huaje nr. ABA-P3), ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (të zëvendësuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në tetor 2008), për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
DATË 23 tetor 2015
Nr. Reference JICA (7 R) 10-23005

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Sh.T. Dr. Shkëlqim CANI, Ministër i Financave, Republika e Shqipërisë

Në lidhje me: Ndryshimin e Marrëveshjes së Huas për Projektin për Përmirësimin e Sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe, ndërmjet Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (zëvendësuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në tetor 2008) dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e datës 30 korrik 2008 (Marrëveshje Huaje nr. ABA-P3)

I nderuar Zotëri,

Në lidhje me notën verbale nr. AM-34/2015-MW/gm, të datës 20 tetor 2015, të dërguar nga Ambasada Japoneze te Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë, e cila shpreh miratimin e Qeverisë Japoneze për kërkesën e Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e periudhës së disbursimit të Marrëveshjes së Huas së sipërpërmendur dhe referuar shkresës suaj, të datës 23 tetor 2013 (nr. 15867/1), që na informon për riemërimin e Agjencisë së Zbatimit, ne biem dakord si më poshtë:

1. Seksioni 2/2 i nenit 1 të Marrëveshjes së sipërpërmendur të Huas do të ndryshohet në “disbursimi përfundimtar i parashikuar në Marrëveshjen e Huas do të kryhet jo më vonë se data 24 tetor 2019 dhe nuk do të ketë disbursime të mëtejshme nga JICA-ja, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet JICA-së dhe Huamarrësit”.

2. Emri i Agjencisë Zbatuese, që përmendet në seksionin 4/1 të nenit III dhe seksioni 3 i skicës 1 të

Marrëveshjes së Huas, si “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” do të ndryshohet në “Ministria e Transportit dhe Infrastruktursë”.

3. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi në datën kur JICA-ja njoftohet se është kryer çdo procedurë e nevojshme për hyrjen e tij në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

4. Kjo shkresë nuk do të interpretohet për autorizimin e ndonjë ndryshimi tjetër, përveç atyre të përmendura më sipër.

Ju lutem, konfirmoni miratimin tuaj për ndryshimin e sipërpërmendur me anë të nënshkri-mit të kësaj shkrese dhe kopjes së bashkëlidhur të saj, duke mbajtur një për protokollin tuaj dhe duke na kthyer tjetrën dhe njoftoni sapo të përfundohet procedura e nevojshme në Republikën e Shqipërisë për këtë ndryshim.

Së fundi, meqë është një rast përjashtimor për Qeverinë Japoneze dhe JICA-ja të miratojë një zgjatje katërvjeçare të periudhës së disbursimit, ne do t’ju kërkonim monitorimin dhe udhëzimin e vendosur të autoriteteve të interesuara, të cilët do të marrin masat e nevojshme për lehtësimin e punimeve të ndërtimit për përfundimin e Projektit dhe pagesave të nevojshme nga Huaja nga data e rishikuar e disbursimit përfundimtar.

Me respekt

Për AGJENCINË JAPONEZE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Nga: _____

Shinichi YAMANAKA

Drejtor i Përgjithshëm

Departamenti i Lindjes së Mesme dhe Europës

Miraturar:

në datën _____

Për QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga _____

Shkëlqim CANI

Ministër i Financave

Në vëmendje të: Z. Ardian Alushi, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës, Ministria e Transportit dhe Infra-strukturës

Z. Toshiya Abe, Përfaqësues Kryesor i Zyrës së JICA-s në Ballkan

Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar

DATE Xxx xx 2015

Nr. Reference JICA (7R) xx-xxxxx

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 1, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Sh.T. Dr. Shkëlqim CANI, Ministër i Financave, Republika e Shqipërisë

Në lidhje me: Ndryshimin e Marrëveshjes së Huas për Projektin e Përmirësimit të Sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe, projekt ndërmjet Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (i zëvendësuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në tetor 2008) dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë 30 qershor, 2008 (Marrëveshje Huaje nr. ABA-P3)

I nderuar Zotëri,

Në lidhje me shkresën për ndryshim nr. JICA (7R) 10-23005, të datës 23 tetor 2015, të dërguar nga JICA-ja në përgjigje të kërkesës së Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e periudhës së disbursimit të Marrëveshjes së Huas së sipërpërmendur, përveç zgjatjes së Marrëveshjes së Huas, ne biem dakord si më poshtë:

1. Koha e supozuar për përfundimin e Projektit, e përmendur në seksionin 3 “Projekti pritët të përfundohet në dhjetor 2014”, do të ndryshohet si “Fillimisht Projekti pritet të përfundonte në dhjetor 2014. Megjithatë, do të ndryshohet në tetor 2019 me zgjatjen e periudhës së disbursimit.

2. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi në datën kur JICA-ja njoftohet se është kryer çdo procedurë e nevojshme për hyrjen e tij në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Kjo letër nuk do të interpretohet për autorizimin e ndonjë ndryshimi tjetër, përveç atyre të përmendura më sipër.

Ju lutem, konfirmoni miratimin tuaj për ndryshimin e sipërpërmendur me anë të nënshkri-mit të kësaj shkrese dhe kopjes së bashkë-lidhur të saj, duke mbajtur një për protokollin tuaj dhe duke na kthyer tjetrën dhe njoftoni sapo të përfundohet procedura e nevojshme në Republikën e Shqipërisë për këtë ndryshim.

Me respekt

Për AGJENCINË JAPONEZE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Nga: _____

Shinichi YAMANAKA

Drejtor i Përgjithshëm

Departamenti i Lindjes së Mesme dhe Europës

Miratuar

në datën _____

Për QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____

Shkëlqim CANI

Ministër i Financave

Në vëmendje të: Z. Ardian Alushi, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Z. Toshiya Abe, Përfaqësues Kryesor i Zyrës së JICA-s në Ballkan

Ajencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar

DATË XX tetor 2015

Nr. Reference JICA (BK) X-XXXX

SHT. Dr. Shkëlqim CANI

Ministër i Financave

Republika e Shqipërisë

Lënda: Ndryshimi i Marrëveshjes së Huas për Projektin e Përmirësimit të Sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe, projekt ndërmjet Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (e zëvendësuar nga Ajencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në tetor 2008) dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e datës 30 qershor 2008 (Marrëveshje Huaje nr. ABA-P3): Rialokim i të ardhurave të Huas

Shkëlqesia Juaj

Referuar shkresës suaj, të datës 1 shtator 2015 (nr. Ref. 10845/3 Prot.), në lidhje me kërkesën për rialokimin e të ardhurave të Huas, ne biem dakord si më poshtë:

1. Tabela e shpërndarjes së të ardhurave të Huas, e cila është pjesë e seksionit 1 të skedulit 2 në Marrëveshjen e Huas së sipërpërmendur do të zëvendësohet me dokumentin e bashkëlidhur kësaj shkrese.

2. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi në datën kur JICA-ja njoftohet se është kryer çdo procedurë e nevojshme për hyrjen e tij në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Kjo letër nuk do të interpretohet për autorizimin e ndonjë ndryshimi tjetër përveç atyre të përmendura më sipër.

Ju lutem, konfirmoni miratimin tuaj për ndryshimin e sipërpërmendur me anë të nënshkrimit të dy kopjeve të kësaj shkrese, duke mbajtur një për protokollin tuaj dhe tjetrën na e ktheni ne.

Me respekt

Toshiya ABE

Përfaqësues kryesor

JICA Zyra në Ballkan

Miratuar:

në datën _____

QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____

Shkëlqim Cani
Ministër i Financave

Në vëmendje të: Mimoza Loli, Drejtuese e Departamentit të Marrëveshjeve, Drejtoria e Borxhit të Përgjithshëm Publik, Ministria e Financave

Z. Ardian Alushi, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës, Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës Z. Shinici YAMANAKA, Drejtor i Përgjithshëm, Departamenti i Lindjes së Mesme dhe Europës.

Dokument i Bashkëlidhur

Skeduli 2

Alokimi i të Ardhurave të Huasë

Seksioni 1. Alokimi

Kategoria	Shuma e Huasë së Alokuar (në milion Jen Japonezë)	% e Shpenzimit për Financim
(A) Punimet e Ndërtimit dhe Prokurimi i Mallrave	9,238	100%
(B) Shërbime Këshillimi	1,556	100%
(C) Interesi gjatë Ndërtimit	232	-
(i) në lidhje me (A) dhe (E)	231	
(ii) në lidhje me (B)	1	
(D) Zërat e Paparashikuar	0	
(E) Detyrimi për Angazhimin Financiar	95	-
TOTALI	11,121	-

